



Komunikatë 'Çfarë ndodh në të vërtetë tek Shërbimi Psikologjik Shkollor?'

Një regjistrim tek shërbimi psikologjik shkollor, shpesh i çliron nga frika jo vetëm fëmijët por edhe prindërit e tyre. Ja para disa këshilla që ju dhe fëmija e juaj mund ti keni parasysh gjatë vizitës së juaj tek ne.

Pse tek SHPSH-ja?

I shpjegoni fëmijës tuaj qetë dhe qartë, pse ju apo mësimdhënësi keni vendosur ta merrni në konsideratë ndihmën psikologjike shkollore. Pranimi i ndihmës psikologjike shkollore nuk është ndonjë dobësi dhe nuk le asnjë gjurmë negative tek personeli i trajnuar (Mësuesit, Pedagoget kuruese, Logopedët, etj.), përkundrazi.

Mos i mashtroni fëmijët tuaj, mos iu tregoni fantazira. Fëmijët e vërejnë menjëherë nëse dikush provon ti mashtroj, apo nëse mundoheni ti u shmangeni (vononi) diskutimeve të drejtpërdrejta (ndershme). Bisedoni shtruar për probleme, dhe bëjani të qartë fëmijut që në këtë moment as ju e as mësimdhënësi nuk mund ta zgjidhin këtë problem, prandaj edhe keni nevojë për një këshillë nga pala e tretë. Mos e zvogëloni problemin por cilësoni atë si një gjë reale. Problemet shkollore janë të zakonshme, prandaj edhe pranimi i ndihmës për zgjidhjen e tyre është gjithashtu i zakonshëm.

Çfarë është SHPSH-ja dhe çfarë ndodh atje?

Vërtet, ne quhemi psikolog shkollor, por ne nuk jemi shkollë. Nuk japim nota, prandaj tek ne ju bile mund ta fyeni (shani) shkollën. Ne do të luajmë me fëmijun tuaj, por ne gjithashtu do kërkojmë edhe rezultate. Mirëpo, këto rezultate nuk do të jenë si ato të shkollës. Ne bisedojmë me fëmijë jo me anë të testeve, por me anë të enigmave dhe detyrave. Fëmijët kanë shumë dëshirë ti zgjedhin enigmat, për atë arsye edhe janë shumë të motivuar për të marr pjesë në sqarimet tona psikologjike. Ju lutëm që edhe ju në shtëpi të provoni ti shmangeni fjalës `Test`.

Ne kërkohet mjaftë nga fëmijët tuaj. Megjithatë, shumica e fëmijëve kanë kujtime të mira nga sqarimet tona psikologjike, dhe shumica bile do të kishin dëshirë të vinin prapë këtu. E kjo ka të bëjë me atë që tek ne fëmijët tuaj e shijon jetën e një të rrituri me përkujdesje të plotë, gjë që asnjëherë nuk ndodh nëpër shkollë.

Nëse fëmijët tuaj nuk dëshirojnë që të qëndroni i vetmuar, ne do të përpiqemi shumë që ai (ajo) ta ndjen vetën mirë tek ne. Ju mund të qëndroni me fëmijën tuaj në fillim të kontrollimit (hulumtimit), deri në atë moment kur ai (ajo) do jetë në gjendje të qëndroj i vetmuar tek ne. Mirëpo gjatë testimit nuk do ishte mirë që prindërit të jenë prezent, pasi që prezenca e tyre ose do i dekoncentron fëmijët ose do i shtynte ata që të tregohen të aftë para prindërve. E kjo gjithë shkakton stres, gjë që mund të ndikonte negativisht në aftësitë e tyre.

Çfarë vlen tjetër që duhet marr parasysh?

- Nëse fëmijë i tuaj mban syza, ai (ajo) do duhej ti mbante ato edhe gjatë kontrollimit (vizitës).
- Kontrollimi (hulumtimi) nuk mbahet me fëmijë të sëmur. Nëse sëmuret fëmijë tuaj ju lutem, anuloni terminin, në rast nevojë edhe për një kohë të shkurtër.
- Ngjarjet sociale me rëndësi siç janë ekskursioni shkollor apo kremtimi i ditëlindjes janë gjithashtu shkak për anulim të terminit. Megjithatë, ju lutem, na lajmëroni me kohë.
- Ju jeni një shembull me rëndësi për fëmijën tuaj. Proveni që përballë sqarimit psikologjik ti shikoni gjërat pozitivisht dhe të jeni zemërpur. Atëherë edhe fëmijë i tuaj nuk do të jetë me ndjenja negative gjatë kontrollimit (hulumtimit).

Jeni të mirëseardhur. Do të ishim shumë të kënaqur të ju takojmë juve dhe fëmijën tuaj.